



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 48
Prishtinë, më 23 qershor 2010
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10
Mbledhja filloi në orën 10:00

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Morën pjesë: Rustem Mustafa, Shkumbin Demaliaj, Suzana Novoberdaliu, Basri Musmurati, Lulzim Zeneli, Zylfi Merxha dhe Luljeta Shehu - anëtarë të Komisionit.

Mungoi: Eqrem Kryeziu dhe Radmila Vujoviq - anëtarë të Komisionit.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Antigona Ibraj, Blerina Pula, Nuredin Ibishi dhe Afrim Hoti.

Mbledhjen e kryesoi: *Rrustem Mustafa, kryetar i Komisionit.*

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të **31. 05. 2010**,
3. Miratimi i Projektligjit për ripranim,
4. Të ndryshme

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të 31.05.2010

Procesverbali i 31.05.2010 u miratua pa vërejtje.

3. Miratimi i Projektligjit për ripranim

Kryetari i Komisionit – Projektligji për ripranim është miratuar në lexim të parë në seancën plenare më 28. 05. 2010. Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri është caktuar si Komision Funksional për shqyrtimin e këtij projektligji. Ky projektligj si një ndër kushtet për marrjen e udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave ka kaluar me një procedurë pak më të shpejtë se projektligjet e tjera. Komisioni Funksional për këtë projektligj ka caktuar referuese nënkryetaren e Komisionit, zonjën Suzana Novoberdaliu.

Suzana Novoberdaliu – Tha se për këtë projektligj është mbajtur një dëgjim publik. Po ashtu kemi mbajtur takime të grupit punues me përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ky projektligj nuk ka shumë ndryshime, janë vetëm dy përmbajtjesore. Kemi vetëm te neni 1, definicionin e kemi riformuluar që të jetë me i qartë dhe kemi një ndryshim te neni 7 për të miturit dhe personat me nevoja të veçanta, ku kemi pasur dy propozime. Në dëgjimin publik kemi pasur propozim nga UNICEF - i, që ky nen të mos fshihet dhe kemi propozimin nga Komisioni Evropian se ky nen kështu nuk thotë asgjë, dhe se ky nen është më mirë të fshihet për arsye se është një lloj diskriminimi t'i veçosh nga shtetasit e tjerë, sepse edhe ata janë shtetasë të Kosovës dhe se të drejtat e tyre janë të garantuara me Kushtetutën e Kosovës dhe me Konventën e Gjenevës. Prandaj ne, si grup punues, kemi vendosur ta heqim, mirëpo unë sot kërkoj që këtu të vendosim ta heqim a jo këtë nen?

Lulzim Zeneli – Tha se nëse hiqet ky nen, kjo do të thotë që edhe fëmijët edhe personat me aftësi të kufizuara do t'i kanë të drejtat e njëjta, si gjithë qytetarët e tjerë. Do të ishte mirë ta dimë këtë çështje si e kanë të rregulluar shtetet e tjera.

Suzana Novoberdaliu - Po edhe këto kategori i gëzojnë të drejtat, siç i kanë edhe shtetasit e tjerë. Shtetet e tjera këto çështje i kanë rregulluar me marrëveshje bilaterale dhe nuk kanë një ligj si ky.

Kryetari - Kërkojmë një sqarim edhe nga këshilltarët e Komisionit që i kemi këtu, fjalën e ka z. Afrim Hoti (Këshilltar nga UNDP- ja).

Afrim Hoti - Për këtë nen është bërë debat i panevojshëm. Ky nen, kështu si është, nuk thotë asgjë. Gjithashtu duhet të kemi parasysh se organizatat i kanë interesat e veta dhe

për ta futur një nen për të drejtat e fëmijëve, për ta do të thotë shumë. Edhe fëmijët edhe personat me nevoja të veçanta i kanë tretman sipas ligjit në Kosovë. Për më tepër të drejtat e fëmijëve në Kosovë janë të mbrojtura me Konventën e OKB - së për të drejtat e fëmijëve. Kjo konventë është në fuqi drejtpërdrejt sipas Kushtetutës së Kosovës dhe për këtë unë e shoh si të panevojshme.

Shkumbin Demaliaj - Unë mendoj se ky nen duhet të hiqet, sepse këtë nen e rregullon neni 15, pra çdo gjë që nuk është e përfshirë si procedurë atëherë nxjerrën akte administrative dhe aty mund të rregullohen të gjitha procedurat.

Anëtarët e Komisionit e miratuan raportin me rekomandime për Projektligjin për ripranim.

5. Të ndryshme

Në këtë pikë nuk kishte çështje për të diskutuar.

Pasi nuk kishte pika të tjera për diskutim, kryetari i Komisionit e mbylli takimin.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30

E hartoi:

Njësia Mbështetëse e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Rustem Mustafa